




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 06.09.2022
Gjakovë

Këshilli Drejtues i Teatrit të Qytetit “Hadi Shehu” duke u bazuar të nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Ligjit për Institucionet e Kulturës Nr. 02/L-57, dispozitave të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L - 106, si dhe Statutit të Teatrit të Qytetit “Hadi Shehu” me numër 01-011/01-20661 të datës 26.09.2017, shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës:	Drejtor i Teatrit të Qytetit “Hadi Shehu”
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Drejtoria:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave:	(1) një
Titulli i mbikëqyrësit:	Këshillit Drejtues
Grada/Koeficienti:	8.5
Kohëzgjatja e emërimit:	Me mandat (4) vjeçar

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- bën menaxhimin financiar, administrativ, teknik dhe promovues të teatrit;
- zbaton vendimet e Këshillit Drejtues të teatrit;
- propozon organizimin e brendshëm të teatrit tek Këshilli Drejtues;
- përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- propozon buxhetin vjetor para Këshillit Drejtues;
- kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
- mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe të donacioneve;
- negocion dhe nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet me artistë të pavarur dhe me palë tjera;
- menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së teatrit;
- menaxhon bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues;
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme dhe kualifikimi:

- Diploma universiteti nga fusha e teatrit ose lëmi të përafërta të kulturës;
- Të ketë 4 vite përvojë pune profesionale në fushën relevante teatrore;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët;
- Njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel, power point, etj;
- Të ketë shkathtësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe ndërnjërzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës dhe në grupe;
- Të ketë aftësi të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kontakteve brenda dhe jashtë teatrit.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Rezymeja Personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (origjinale dhe jo me e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Dëshmi të përvojës së punës.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Testimi me shkrim dhe intervistë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data **06.10.2022** deri **20.10.2022**

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacionet merren në Qendrën e Informimit, kati përdhese në ndërtesën e administratës së Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës. I plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Pranimi apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Gjakovës, Rr. “UÇK” nr. 53, 50000 Gjakovë.
- Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Shpallja e rezultateve përfundimtare:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve rezultateve do të shpallen në linkun:

<https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/>